

VENDIM
Nr.356, datë 12.5.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE, MASTER I NIVELIT TË PARË, NË
“TEKNIK IMAZHERI”, NË FAKULTETIN E INFERMIERISË, TË UNIVERSITETIT
TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË
SHKOLLIMIT, NË KËTË PROGRAM STUDIMESH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Hapjen, në Fakultetin e Infermierisë të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të dytë, Master i Nivelit të Parë, në “Teknik imazheri”.

2. Në përfundim të këtij programi studimesh, lëshohet diplomë “Master i Nivelit të Parë, në teknik imazheri”.

3.Ky program studimi e fillon veprimtaritë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4.Programi i studimit Master i Nivelit të Parë realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatje normale e tij është 1 (një) vit akademik.

5.Kuota e pranimi në këtë program studimi, për vitin akademik 2010-2011, është 60.

6.Nga kuota e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, për këtë program studimesh, caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

7.Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8.Tarifa e shkollimit, për këtë program studimesh, të ciklit të dytë, është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

9.Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

10.Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

11.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha